



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar Punimjen / Prodato Received / Delivery	13.05.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHK	2801/2022		1/6



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.380/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimin me numër A.nr.1731/19 të datës 08.04.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka në shqyrtuar ankesën me numër A.nr.239/2019 të datës 10.04.2019 të parashtruar nga ankueses në Komunë të Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 neni 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Shqyrtimit dhe vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 13.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.239/2019 e datës 10.04.2019 e parashtruar nga ankuesja

II.ANULOHET procedura e rekrutimit për pozitën “Zyrtar i Larte për Ekzaminim” në Agjencinë për Pronësi Industriale, e shpallur sipas konkursit me numër reference MTI/15 të datës 04.12.2018, nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

II.OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që ta bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit 15 dite nga dita e pranimit të këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për shërbim Civil te Kosovës, duhet te njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes se veprimeve ne pajtim me ketë vendim.

A r s y e t i m

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me datë 04.12.2018 ka shpallur konkursin e jashtëm me numër reference MTI/15 për pozitën “Zyrtar i Larte për Ekzaminim”, në Agjencinë për Pronësi Industriale, pasi që me datë 03.12.2018 ka marrë autorizimin nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e

Administratës Publike, në të cilin konkurs ankuesja ka aplikuar dhe ka marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit (listën e shkurtër, testin me shkrim dhe me gojë). Më datë 16.01.2019 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ka bërë shpalljen e rezultateve të procedurës së rekrutimit, në të cilën ankuesja është renditur e dyta (2) me gjithsej 69.4 pike të përgjithshme.

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datës 16.01.2019 për shpalljen e rezultateve të procedurës së rekrutimit me datë 14.02.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Ankuesja pasi nuk ka marrë përgjigje brenda 30 ditëve me date 19.03.2019 përmes adresës elektronike zyrtare i është drejtuar Njësisë së Burimeve Njerëzore lidhur me vendosjen e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë Tregtisë dhe Industrisë sipas ankesës së datës 14.02.2019. Njësia e Burimeve Njerëzore me tw njëjtën datë i është përgjigjur se deri me tani nuk ka pranuar vendim nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave lidhur me ankesën e datës 14.02.2019 te parashtruar nga ankuesja.

Ankuesja kundër heshtjes administrative të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë Tregtisë dhe Industrisë, me datë 10.04.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokoll 1835/2019, me pretendime ankimore kundër përzgjedhjes përfundimtare nga komisioni përzgjedhës, duke pretenduar se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me parimet e ligjit për shërbimin civil, nga formimi i listës së ngushtë, në testin me shkrim ku në pjesën e I-rë, nuk i është bërë vlerësimi i drejtë për mos vendosjen e pikëve në formularin e testit me shkrim në pyetjet e 3, 4, dhe 5, ku përgjigjet pretendon se janë të sakta dhe i është bërë vlerësim minimal, po ashtu dhe në pjesën e III-të në pyetjen e 7 dhe të 8 në formë eseje nuk janë vendosur piket, dhe si rezultat i kësaj poentimi në testim me shkrim dhe intervistës me gojë, nuk ka arritur pikët më të larta për tu renditur e para në listë si kandidates së përzgjedhur.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.04.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Më datë 17.04.2019, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 17.06.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 08.04.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1731/19, te cilin Këshilli e ka pranuar me date 15.04.2022, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 17.06.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 10.04.2019.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Aktgjykimin A.nr.1731/19 të datës 08.04.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, i pranuar me datës 15.05.2022 në Këshill; Ankesën me Anr.239/2019 protokollin 1835/2019 e datës 10.04.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 10.02.2019 protokollin 1438: Vlerësimi Individual i Kandidatëve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë Gjuhe të Huaj; Form.MAP-SHCK-10 renditja përfundimtare e kandidatëve: Form.MAP-SHCK-09 Përmbledhja e Vlerësimeve Individuale; Kërkesa për Qasje në Dokumentet Publike: Emaili i datës 04.10.2019 Njoftimi për shtyrjen e mbajtjes së Seances së Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave për Shqyrtimin e ankesës Nr.1438: Njoftimi i datës 16.01.2019 për kandidaten e Suksesshme: Kërkesa për Përgjigje në Ankesë e datës 11.04.2019 protokollin 1864/2019: Përgjigjia në Kërkese e datës 17.04.2019 protokollin 3354: Autorizimi i Publikimit të konkursit i datës 03.12.2018: Rekrutimi i datës 04.12.2018: Form. MAP-SHCK-04 Regjistri i Aplikacioneve të Pranuara: Vendimi i datës 19.12.2018: Testi me shkrim; Formulari i Aplikimit të kandidatës [redacted] i datës 06.12.2018 së bashku me dëshmitë për përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës: Formulari i Aplikimit të kandidatës [redacted] së bashku me dëshmi për përgatitje profesionale dhe përvojën e punës: Ankese e datës 14.02.2019: Form. MAP-SHCK-10, Rënditja përfundimtare e kandidateve.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se procedura e rekrutimit të shpallur me datë 04.12.2018 nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, për pozitën „Zyrtar i Lartë për Ekzaminim“, është zhvilluar në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se në konkursin e shpallur me datë 04.12.2018 nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, për pozitën „Zyrtar i Lartë për Ekzaminim“, kriteret e konkursit kanë qenë:

- **Diplome Universitare, Juridik, Ekonomik, Shkenca Teknike, Teknologjike,**
- **minimumi 3 vite përvojë pune profesionale.**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se pretendimet e ankueses janë të qëndrueshme, sepse Ministria e Tregtisë dhe Industrisë procedurën e rekrutimit të shpallur me datë 04.12.2018 për pozitën „Zyrtar i Lartë për Ekzaminim“, e ka zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, sepse pas administrimit të provave është konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, me rastin e formimit të listës së ngushtë me datë 26.12.2018 ka përfshirë kandidaten e cila nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit, gjegjësisht nuk e ka plotësuar kriterin e përvojës së punës pas diplomimit „**minimumi 3 vite përvojë pune profesionale**“, siç është kërkuar në konkurs.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të gjitha dëshmive për përvojën e punës të bashkëngjitura në dosjen e kandidatës së pranuar dhe në dosjen e ankueses, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, ka dështuar të vlerësoj drejtë dëshmitë e përvojës së punës të kandidatës së përzgjedhur,

sepse kandidatja e përzgjedhur [redacted] bazuar në dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit, nuk e ka plotësuar kriterin e përvojës së punës pas diplomimit, gjegjësisht nuk ka ofruar dëshmi të përvojës së punës tri (3) vite pas diplomimit, andaj Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin e përfshirjes në listën e shkurtër, respektivisht përzgjedhjes së kandidatës [redacted] ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 28 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: **“Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: 1.2. përvoja e punës”** dhe nenit 17 paragrafit 2 nën paragrafit 2.9 të Rregullores Nr. 05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil i cili përcakton se: **“Karakteristikat e nivelit profesional tre (3) janë: Kërkon njohuri të thella dhe të specializuara të fituara përmes shkollimit universitar, trajnimeve përkatëse dhe së paku tri (3) vite përvojë pune”**, çka nënkupton se e gjithë përvoja e punës në rastin konkret duhet të jetë fituar pas shkollimit universitar sepse kjo është e ndërlidhur me parimin e profesionalizimit e përcaktuar me nenin 11 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: **“1. Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimt të kandidatëve”**.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas analizimit të lëndës dhe dëshmimeve të ofruara nga organi i punësimit për kandidaten e pranuar dhe ankuesen ka konstatuar, se kandidatja e suksesshme për pozitën “Zyrtare e Lartë për Ekzaminim”, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë nuk e ka plotësuar kriterin e kërkuara sipas konkursit të shpallur gjegjësisht kriterin e **përvojës së punës profesionale pas diplomimit, për shkak se:** Kandidatja [redacted] ne baze të dëshmimeve të ofruara në dosje me rastin e aplikimit posedon Diplomë me nr.7281 të lëshuar nga Universiteti “Hasan Prishtina” me të cilën dëshmohet se ka përfunduar Fakultetin Ekonomik me datë 25.10.2016, dhe ka marrë titullin: Bachelor në Banka Financa dhe Kontabilitet, ndërsa sipas dëshmimeve të ofruara ka këtë përvojë pune si në vijim: sipas vërtetimit të datës 25.01.2018 të lëshuar nga N.N.P. “Standard Plus”, nga Banja e Malishevës kandidatja ka punuar nga data 04.01.2014 deri me datë 30.12.2016 në pozitën „Administratore”; prej datës 01.03.2018 deri me datën 01.09.2018, në pozitën “Zyrtare për çështje administrative” në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë; si dhe prej datës 01.09.2018- vazhdon (deri me mbylljen e konkursit date 18.12.2018) në pozitën “Zyrtare për çështje administrative” në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave sipas dëshmimeve të lartpërmendura për përvojën e punës të ofruara në dosje nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ka konstatuar që kandidatja [redacted] deri në mbylljen e konkursit ka pasur gjithsejtë një (1) vite, e dy (2) muaj e njëzet e tre (23) ditë përvojë të punës profesionale pas diplomimit, andaj Kolegji konstaton se kandidatja e përzgjedhur [redacted], e nuk e ka plotësuar **kriterin e konkursit, sa i përket përvojës së punës profesionale, ndërsa** ankuesja ne baze të dëshmimeve të ofruara në dosje me rastin e aplikimit posedon Diplomë me nr. 3744 të lëshuar nga Universiteti “Hasan Prishtina” me të cilën dëshmohet se ka përfunduar Fakultetin Ekonomik me datë 07.10.2013, dhe ka marrë titullin: Bachelor për Ekonomikes, ndërsa sipas dëshmimeve të ofruara ka këtë përvojë pune si në vijim: sipas vërtetimit të muajit prill të vitit 2017 të lëshuar nga SH.P.K. „Imazh” nga Prishtina kandidatja ka punuar nga data 04.11.2013 deri me datë 04.04.2017 në pozitën „Zyrtare Financiare-Administrative; prej datës 20.04.2017 deri me datë 20.04.2018, në pozitën „Eksperte për zhvillim dhe realizim të Projekteve” në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave sipas dëshmimeve të lartpërmendura për përvojën e punës të ofruara në dosje nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ka konstatuar që ankuesja [redacted] e ka plotësuar **kriterin e konkursit, sa i përket përvojës së punës profesionale qe duhet ti ketë minimumi 3 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke marre parasysh shkeljet procedurale dhe ligjore të theksuara më lartë, konstaton se procedura e rekrutimit është bërë në kundërshtim edhe me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: „**Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës**”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se procedura e rekrutimit nuk është zhvilluar në pajtim me parimet e ligjit për shërbimin civil të Kosovës, gjegjësisht komisioni përzgjedhës nuk i ka bërë vlerësimin e drejtë të pikëve në përllogaritje nga testi me shkrim dhe me gojë, respektivisht vlerësimi nuk i është bërë në çdo pyetje edhe pse ankuesja është përgjigjur në çdo pyetje, kështu duke e lënë testin me shkrim tek pyetjet dhe përgjigjet e caktuar të pa vlerësuar me pikë apo me zero(0)pikë, në raport me testin me shkrim të kandidates së përzgjedhur.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankueses e cila pretendon se Komisioni Përzgjedhës nuk i ka bërë vlerësimin e drejtë të pikëve në përllogaritje në testin me shkrim dhe me gojë, konstaton se pretendimi i ankueses është i bazuar, sepse Komisioni Përzgjedhës vlerësimin e kandidatëve në testin me shkrim e ka bërë në kundërshtim me nenin 33, 34 si dhe 37 të Rregullores Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, sepse në bazë të provave të lëndës respektivisht testit me shkrim, është vërtetuar se pretendimet e ankueses lidhur me pikët e pa vendosura në testin me shkrim, janë të qëndrueshme sepse, Komisioni Përzgjedhës ka dështuar të plotësoj dhe vlerësoj testin sipas rregullores, sepse ka pyetje të cilat për ankuesen nuk janë vlerësuar fare.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se përkundër faktit se Komisioni Përzgjedhës në Shërbimi Civil, testin me shkrim e ka përpiluar në pajtim me nenin 36 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, 1.2 dhe nën paragrafin 1.3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, vlerësimi i pikëve për ankuesen në raport me kandidaten e përzgjedhur nuk është bërë i drejtë. Lidhur me ligjshmërinë e procedurës së rekrutimit për pozitën “Zyrtar i Lartë për Ekzaminim”, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se me datë 15.01.2019, Komisioni përzgjedhës ka rekomanduar kandidaten

e cila ka grumbulluar gjithsejtë 75.5 pikët e përgjithshme nga testi me shkrim dhe me gojë, ndërsa ankuesja është vlerësuar me gjithsejtë 69.4 pikë të përgjithshme nga testi me shkrim dhe me gojë, duke u renditur e dyta (2) në listën përfundimtare, mbi këtë bazë është konstatuar se përzgjedhja e kandidates është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenit 18 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton që: “**Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës**” si dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatësisht nenin 41 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me rastin e shpalljes së rezultateve të procedurës së rekrutimit.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me rastin e lëshimit të Aktit Zyrtar të Emërimit për kandidaten e suksesshme nga kjo procedure e rekrutimit, kanë vepruar në kundërshtim me nenin 3 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: “**Nëpunësit civil punësohen në bazë të meritës, pasi të jenë nënshtruar procedurës përzgjedhëse, e përcaktuar në bazë të këtij ligji dhe akteve përkatëse nënligjore**”.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.380/2022.**

*Zyle Milaku GOJNOVCI*

*Procesmbajtëse*

*Malsore GASHI BAJRAKTARI*

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë;
- Kryeshefit të Përgjithshme në Agjencinë për Pronësi Industriale;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.